

**Z. Jonild Hoxhaj**, ka përfunduar studimet në vitin 2010 në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Inxhinieri Ndërtimi dhe në vitin 2017 ka përfunduar studimet në nivelin Master Profesional, dega Financë Kontabilitet.

Ai është certifikuar në Kursin e Auditimit të Energjisë në vitin 2017 dhe si Vlerësues i Pasurive të Paluajtshme në vitin 2016.

Z. Hoxhaj ka ushtruar profesionin e vet si inxhinier në Agjencinë e Legalizimit dhe Urbanizimit e Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) për gati 3 vite 2009 – 2012 dhe më pas për një periudhë 2 vjeçare 2012 – 2014 në një subjekt privat në fushën e ndërtimit.

Prej vitit 2014 nisi punën si auditues në KLSH.

Aktualisht është në pozicionin Kryeauditues në Departamentin e Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja dhe e ushtron këtë pozicion që prej shkurtit të vitit 2018.

Në vitin 2016 ka marrë pjesë në një Program Trajnimi Internship të mundësuar nga Gjykata Evropiane e Auditimit (ECA) në Luksemburg, ku ishte pjesë e Departamentit të Investimeve për Kohezionin, Rritjen dhe Përfshirjen duke dhënë kontribut në draft raportin final të auditimit për vitin financiar 2015, një propozim konkret për auditimin e projekteve për Energjinë e Rinovueshme nga Fondet Evropiane për Zhvillimin e Rajoneve si dhe duke u angazhuar si anëtar grupi në auditimin e bërë sipas programit Calabria FESR – 2007 – 2013.

Mbështetur në eksperiencën audituese, ka dhënë një kontribut të vlefshëm edhe në botimet në median e shkruar nga stafi i KLSH, me shkrime si: Dritëhijet e investimeve të reklamuar si sukses – viti 2020; Investimet publike dhe (dis)favoret e korrupsionit – viti 2020; Pandëshkueshmëria në administratë krijon pasoja me shkelje ligjore – viti 2016; Investimet publike dhe problematikat që i shoqërojnë ato – viti 2016; Bashkëveprimi KLSH – Media, një përjasje mes Institucionit dhe publikut – viti 2015;

Z. Hoxhaj është njohës shumë i mirë i gjuhës angleze dhe italiane.